



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT  
TË PUSHTETIT LOKAL



KOSOVO LOCAL  
GOVERNMENT  
INSTITUTE



# AUDITIMI SOCIAL

---

KOMUNA E SKENDERAJT  
JANAR, 2025



## PËRMBAJTJA

RRETH KLGJ.....	5
RRETH MAPL.....	5
HYRJE.....	6
PROFILI I KOMUNËS.....	7
KONCEPTI I AUDITIMIT SOCIAL.....	8
PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL.....	9
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	10
HAPAT E PROCESIT TË AUDITIMIT SOCIAL.....	11
METODOLOGJIA.....	11
RRETH PROJEKTEVE.....	13
GJETJET KRYESORE.....	15
REKOMANDIME.....	16
KOMENTET E KOMUNËS.....	17
LISTA E GRUPIT TË AUDITIMIT SOCIAL.....	18

## RRETH KLGJ

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) është organizatë profesionale e dedikuar për të përmirësuar dhe forcuar qeverisjen lokale në Kosovë.

KLGJ është themeluar në vitin 2008 bazuar në modele ndërkombëtare të organizatave profesionale. Instituti synon të kontribuojë në vazhdimësinë e procesit të reformave në çështjet e qeverisjes lokale dhe të avancojë sistemin e decentralizuar të qeverisjes, me theks të veçantë në rritjen e llogaridhënies dhe zhvillimin e kapaciteteve në nivel komunal.

Fokusi i KLGJ-së është në konsolidimin demokratik dhe mirë-funksionimin e institucioneve të nivelit lokal lidhur me praktikat dhe trendët bashkëkohore. Në këtë perspektivë, KLGJ-ja është aktive përmes hulumtimeve, avokimit, rrjeteve, këshillave për politika publike, ngritjen e kapaciteteve dhe forma të tjera të mbështetjes për qeverisjen lokale.

## RRETH MAPL

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) është institucion i administratës shtetërore të Republikës së Kosovës, e themeluar në vitin 2004. Funksionin e saj, MAPL-ja e ushtron në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Përgjatë këtyre viteve, MAPL-ja ka qenë direkt e përfshirë në procesin e reformës së pushtetit lokal, respektivisht shtrirjen e procesit të decentralizimit në vend, sigurimit të kompetencave të mjaftueshme të pushtetit lokal dhe ushtrimit të tyre në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin e zbatueshëm. MAPL-ja ndjek një politikë të afirmimit të të drejtave të komunave në rregullimin e çështjeve publike, krijimit të kapaciteteve të mjaftueshme të komunave për të ushtruar veprimtarinë e tyre në pajtim me parimin e ligjshmërisë, subsidiaritetit, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit dhe parimeve të tjera të qeverisjes së mirë.

Misioni i Ministrisë është të rritet autonomia lokale dhe të forcohet aftësia e komunave, që nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe përfaqësimit demokratik, të ofrohen shërbime me kosto efektive për të rritur cilësinë e jetës, sigurinë dhe ekonominë lokale.

## HYRJE

Auditimi Social i zbatuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) dhe i mbështetur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në Kosovë, ka për qëllim forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive.

Projektet e audituara nga grupi:

1. Rikonstruimi i kulmeve të Shkollave në Çirez, Llaushë dhe "Anton Çetta" në Qytet;
2. Poligoni sportiv në Shkollën "Ahmet Delia" në Qytet.

Raporti paraqet metodologjinë e zbatuar nga Grupi i Auditimit Social, përfshirë:

- i. Mbledhjen e informacionit; sigurimin e kontratave; analizimin e kontratave sipas parametrave dhe krahasimet me modelet dhe standardet;
- ii. Monitorimin në terren; takimet me përfitues dhe informacione rrethore (bizneset, qytetarët e rastit si dhe specialistë);
- iii. Hartimin e gjetjeve dhe rekomandimeve;
- iv. Adresimin/konfirmimin e gjetjeve në takimin me komunën.

Ky aktivitet është mbështetur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në Kosovë, që ka për qëllim forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive gjithëpërfshirëse dhe kohezive.

Instituti KLGJ, nëpërmjet Auditimit Social ka tri synime:

1. Rritjen e informacionit dhe njohurive për Auditimin Social;
2. Përfshirjen e qytetarëve në proceset publike lokale;
3. Ndërtimin e praktikave për angazhim të vazhdueshëm publik.

# PROFILI I KOMUNËS

## Skënderaj

### Zona dhe Popullsia

Komuna e Skënderajt gjendet në zonën veriqendër të Kosovës. Përfshin një sipërfaqe prej 378 km<sup>2</sup> me qytetin e Skënderajt dhe 49 fshatra. Sipas Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave të Kosovës 2024, popullsia e përgjithshme është **40,664** banorë rezidentë.

### Struktura Qeverisëse dhe Pasqyra Politike

Numri i përgjithshëm i votuesve në Komunën e Skënderajt, të regjistruar për zgjedhjet e fundit komunale të mbajtura në tetor 2021 ishte 53,479 duke përfshirë votuesit jashtë Kosovës. Pjesëmarrja në votime ishte 43.5 për qind/22.615 votues (burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve).

*Përbërja e Kuvendit Komunal nga Zgjedhjet Lokale 2021:*

### 1. Legjislativi

Kuvendi Komunal: **31 ulëse**

#### Rezultatet e zgjedhjeve:

<b>PDK – Partia Demokratike e Kosovës</b>	54,04%	17
<b>Lista e Pavarur – Bekim Jashari</b>	31,59%	10
<b>LVV – Lëvizja Vetëvendosje</b>	5,60%	2
<b>Nisma– Nisma Socialdemokrate</b>	1,69%	1
<b>AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës</b>	1,86%	1

### 2. Ekzekutivi

Kryetari i Komunës: **Fadil Nura (PDK)**

Drejtoritë e Komunës: **12**



### TË ARDHURAT BUXHETORE

Kategoria	Vlera
a. Të hyrat vetanake	1,709,466€
b. Granti i Përgjithshëm	8,450,648€
c. Granti Specifik për Arsim	7,286,969€
d. Granti Specifik për Shëndetësi	2,234,388€
e. Shërbime Rezidenciale	200,000€
<b>Totali</b>	<b>19,881,471€</b>

### BUXHETI NË KATEGORI

Kategoria	Vlera
a. Pagat dhe shtesa	11,020,774€
b. Mallra dhe shërbime	2,846,807€
c. Shpenzime komunale	287,300€
d. Subvencionet dhe transferet	1,147,000€
f. Investimet kapitale	4,579,591€

*Komuna e Skënderajt ka:*

*Buxhet total: 19,881,472 Euro*

*Staf komunal: 1,362*

## KONCEPTI I AUDITIMIT SOCIAL


Auditimi Social është njëri nga mjetet e informimit, përfshirjes dhe angazhimit qytetarë në proceset komunale. Si dhe njëra nga metodat e kontributit konstruktiv të akterëve (qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit), në veçanti e përfituesve fundorë të investimeve komunale.

Ky proces synon të kontribuojë reciprokisht në dy dimensione: në njërën anë, të zgjerojë informacionin, njohuritë dhe përfshirjen e qytetarëve në të gjitha stadet e zhvillimit të investimeve komunale (planifikim, zbatim, monitorim si dhe vlerësim) dhe në anën tjetër, të rrisë interesin e autoriteteve lokale për të forcuar pronësinë dhe kontributin direkt të qytetarëve në investimet komunale. Në fokus, për të rritur nivelin e performancës së komunave, në të gjitha stadet e investimeve kapitale nëpërmjet kontributit dhe monitorimit qytetar.

Auditimi Social është në frymën e parimeve të qeverisjes së mirë, duke siguruar se autoritetet lokale, marrin parasysh nevojat, kërkesat dhe interesat publike në proceset e politik-bërjes dhe vendimmarrjes komunale. Si dhe duke siguruar parimet e gjithëpërfshirjes dhe kohezionit social në komuna. Auditimi Social merr kuptim të plotë, atëherë kur publiku ka informacion, është i përfshirë dhe ka rol në proceset e politikave lokale. Përtej mjeteve dhe mekanizmave të zakonshëm, Auditimi Social, ka karakterin e bashkë-dizajnit dhe bashkë-krijimit të politikave lokale. Si hisedar, ai merr edhe rolin e monitoruesit dhe vlerësuesit të zbatimit dhe ndikimit real të investimeve komunale. Kështu, synimi parësor është të forcojë besimin reciprok në mes qytetarëve dhe autoriteteve lokale.

Instituti KLGJ, përgjatë këtij cikli të Auditimit Social, ka vendosur në fokus që pronësia e procesit të bartet tek organizatat dhe aktivistët lokalë, kjo duke siguruar qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të proceseve. E, njëkohësisht, që t'i ofrojë nivelit lokal metodologji, mjete dhe kapacitete, për të shtrirë Auditimin Social edhe në projektet tjera komunale.

Për të siguruar qasje sa më efektive në zbatim, Instituti KLGJ, është angazhuar në tri (3) dimensione: i. grupet e auditimit të reflektojnë gjithëpërfshirjen e qytetarëve; ii. njohja e vlerave dhe interesave të komunitetit lokal; iii. ndërthurja e dy të parave me proceset, praktikat dhe mekanizmat komunalë.



# PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL

## Themelimi i Grupit të Auditimit Social/Trajnimit

Për të rritur fokusin e Auditimit Social, duke pasur parasysh shtrirjen (zonën) e projekteve, grupi është përbërë nga përfaqësues të shkollave, organizata dhe prindër, duke siguruar gjithëpërfshirje. Fillimisht janë informuar dhe konsultuar përfaqësuesit e shkollave, rreth projektit dhe përfshirjes. Pas angazhimit të tyre, janë identifikuar edhe qytetarë të tjerë nga struktura dhe përvoja të ndryshme, duke rritur diversitetin e grupit si: prindër, përfaqësues të klubeve sportive, HANDIKOS, specialistë të fushës së edukimit si dhe përfituesit direkt (përfaqësuesit e shkollave). Në grup të Auditimit Social janë përfshirë 14 pjesëmarrës, prej tyre 6 vajza/gra.

### Takimi i parë

Fillimisht, më datë: **28 qershor 2024** u zhvillua takimi koordinues dhe trajnimit për gjashtë (6) organizatat partnere të përfshira në procesin e auditimit social. Ndërsa, nëpërmjet letrës informuese, më datë: **7 korrik 2024**, është njoftuar Komuna e Skënderajt mbi projektet e përfshira dhe organizatën partnere lokale që do ta zbatojë Auditimin Social. Më datë: **5 gusht 2024**, është themeluar grupi i Auditimit Social dhe është mbajtur takimi i parë/trajnimit. Para nisjes së procesit, Grupi i Auditimit Social ka marrë informacione dhe njohuri të thelluara mbi funksionimin e qeverisjes lokale në Kosovë, mekanizmat e pjesëmarrjes dhe proceset e auditimit social. Auditimi Social është zhvilluar në partneritet mes Institutit KLGJ dhe OJQ Skenderajlive (Qendra Rinore).

### Takimi i dytë

Më datë: **4 tetor 2024**, në Komunën e Skënderajt u mbajt takimi i dytë me pjesëmarrjen e 11 personave, prej tyre 5 ishin gra. Takimi i organizuar nga grupi i auditimit social, kishte për qëllim analizimin e kontratave, skicave dhe dokumenteve të dy projekteve kryesore:

1. Rikonstruimi i kulmeve të shkollave (Çirez, Llaushë dhe Shkollën "Anton Çetta"- qytet);
2. Ndërtimi i poligonit sportiv në Shkollën "Ahmet Delia"- qytet.

Në takim, përfaqësuesit e tri (3) shkollave ndanë mendimet e tyre për zhvillimin e punimeve, duke vlerësuar progresin deri në këtë fazë. Grupi i Auditimit Social theksoi nevojën për komunikim të vazhdueshëm në mes të drejtuesve të shkollave dhe ekipeve të ndërtimit për të adresuar çdo shqetësim në kohë. Grupi e mirëpriti ndërtimin e poligonit sportiv, por theksoi rëndësinë e përdorimit të materialeve cilësore për të garantuar sigurinë e fëmijëve gjatë aktiviteteve sportive. Ata nënvizuan se investimi në cilësi është thelbësor për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të përshtatshëm për zhvillimin fizik dhe mirëqenien e nxënësve.

### Takimi i tretë/Vizita në terren

Takimi i tretë u mbajt më datë: **19 dhjetor 2024**, ku grupi i Auditimit Social kreu një vizitë në terren për të vlerësuar progresin e punimeve të kryera deri në atë fazë. Fillimisht ka analizuar detajet e kontratës dhe realizimin, pastaj ka vlerësuar anët pozitive dhe mangësitë e planifikimit. Pas kësaj, grupi ka hartuar gjetjet dhe rekomandimet.

### Takimi me komunën/adresimi i gjetjeve dhe ndarja e rekomandimeve

Takimi i katërt me komunën është mbajtur me datë: 22 janar 2025. Grupi i Auditimit Social në Skënderaj ka ndarë gjetjet dhe rekomandimet me Kryetarin e Komunës dhe ekipin, për projektet e monitoruara. Ku u diskutuan gjetjet dhe u ndanë rekomandimet e projektit të përfshirë në këtë proces të monitorimit. Pas komenteve të komunës, janë reflektuar komentet në raportin final.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë periudhës **qershor 2024 - shkurt 2025**, Instituti KLGJ me mbështetjen nga MAPL, ka zbatuar procesin e Auditimit Social në gjashtë (6) komuna, pjesë e financimit nga Granti i Performancës komunale, përfshirë edhe Skënderajin.

Në Komunën e Skënderajt kanë kaluar në procesin e Auditimit Social këto projekte:

1. Rikonstruimi i kulmeve të Shkollave Çirez, Llaushë dhe "Anton Çetta" në qytet;
2. Poligoni sportiv në shkollën "Ahmet Delia" në qytet.

Instituti KLGJ ka përzgjedhur koordinatorin për komunën e Skënderajt, duke e përfshirë në platformën [www.klgi-platform.com](http://www.klgi-platform.com), ku janë ndarë dhe zbatuar detyrat në këtë sekuencim: Koordinatorët, pas vlerësimit të shtrirjes gjeografike të projekteve si dhe strukturës së tyre, kanë identifikuar dhe përzgjedhur qytetarët (aktivistë, pjesë e shoqërisë civile, anëtarë të Këshillave Lokalë, profesionistë, përfaqësues apo direkt pjesëtarë të grupeve të nën-përfaqësuar dhe përfitues fundorë); Instituti KLGJ dhe koordinatori, kanë përcaktuar dhe përgatitur takimin e parë/trajnimin, ku më pas është rivlerësuar për nevojën e zgjerimit të grupit pas analizimit fillestar të projektit si dhe kanë krijuar grupin e komunikimit elektronik; Koordinatorin dhe grupin kanë përcaktuar takimet e dyta/vizitat në terren, duke konsultuar përfituesit dhe marrë informacione rrethanore nga bizneset, qytetarët e rastit si dhe specialistë; Pas mbledhjes së informacioneve nga terreni, në takimin e tretë, janë hartuar gjetjet dhe nxjerrë rekomandimet; Në takimin me komunën janë adresuar gjetjet dhe janë paraqitur rekomandimet nga procesi i Auditimit Social.

Grupi i Auditimit Social konsideron se projektet e zhvilluara si: Rikonstruimi i kulmeve të Shkollave Çirez, Llaushë dhe "Anton Çetta" dhe Poligoni sportiv në Shkollën "Ahmet Delia", janë përtej një investimi kapital. Grupi i Auditimit Social, ka vendosur në fokus të auditimit pesë dimensione: transparencja dhe konsultimi i publikut; efektet e shfrytëzimit të fondeve publike në komunitet; vlerësimi i kontratës dhe punimeve në terren, si dhe mënyra e adresimit të problemeve që dalin gjatë zbatimit të kontratave.

Sigurimi i kontratave dhe dokumentacionit përcjellës si pjesë e vlerësimit të transparencës është kryer nëpërmjet kërkimit në ueb faqe, kërkesave për qasje në dokumente publike. Ndërkaq, nëpërmjet diskutimeve me përfituesit është vlerësuar niveli i konsultimit në fazat e planifikimit, zbatimit dhe mbikëqyrjes. Në nivel të vlerësimit të përgjithshëm, janë përdorur analizimi i detajeve të kontratës, progresi i shpenzimeve, pranimi i punimeve; vlerësimi në terren, konsultimi me përfituesit si dhe vlerësimi i gjetjeve përtej kontratës; vlerësimi i mjeteve të reagimit nga përfituesit për rrjedhën e zbatimit të projekteve; dhe standardet e punimeve në këto fusha si (kulmet e shkollave dhe poligonin sportiv).

Është konkluzion i përgjithshëm se përdorimi i Grantit të Performancës, ka pasur ndikim direkt në komunitet. Projektet e riparimit të kulmeve në tri shkolla, si dhe poligoni sportiv ka për fokus numër të madh të përfituesve. Në vlerësimin e projekteve, të parat dalin si pjesë e vlerësimit të rritjes së mirëmbajtës apo edhe emergjencës ndërkaq, poligoni sportiv del si rezultat i nevojës bazë për infrastrukturë shkollore.

Megjithatë, përgjatë Auditimit Social janë konstatuar disa gjetje: te riparimi i kulmeve të shkollave, vërehet se në të tri nga to, lidhja e rrjetit të kullimit (ulluqeve) nuk është planifikuar në para-masa dhe para-llogari. Si i tillë, projekti nuk ka arritur të përmbushë efektin e plotë, në veçanti sa i përket eliminimit (largimit) të ujit nga objekti si dhe trotuari. Ndërkaq, sa i përket projektit të poligonit sportiv, gjetja

kryesore ka të bëjë me planifikimin jo të saktë të kostos së investimit, duke shtyrë operatorin të tërhiqet nga kontrata, si dhe komunën në shtimin e mjeteve financiare.

*\*Detajet janë të paraqitura në pjesën e gjetjeve, rekomandimeve dhe komenteve të komunës.*

## HAPAT E PROCESIT TË AUDITIMIT SOCIAL

Procesi i Auditimit Social, referohet në metodologjinë e punës përfshirë:


- i. **Mbledhjen e informacionit** – sigurimin e kontratave; analizimin e kontratave sipas parametrave, krahasimet me kriteret, parimet dhe standardet;
- ii. **Vizitat/monitorimin në terren** – takimet me përfitues dhe informacione rrethore (bizneset, qytetarët e rastit si dhe specialistë) dhe komentet e anëtarëve të grupit;
- iii. **Puna e grupit të Auditimit Social** – hartimin e gjetjeve dhe rekomandimeve;
- iv. **Takimi në Komunë** – adresimin/konfirmimin e gjetjeve në takimin me komunën dhe ndarja e rekomandimeve.

## METODOLOGJIA

**Përzgjedhja e Projekteve, Komunave dhe Grupit të Auditimit**

Instituti KLGJ, referuar **Aneksit I**, të kontratës (KLGJ – MAPL) duke marrë listën e projekteve të bashkëfinancuara nga MAPL dhe Komunitat në kuadrin e Grantit të Performancës Komunale me nga dy projekte. Ky rregull ka vlejtur në tri (3) komuna (*Viti, Skënderaj dhe Kaçanik*), me nga një (1) projekt tri (3) komuna (*Drenas, Shtime dhe Ranillug*). Komunitat ku është kryer Auditimi Social, ofrojnë një pasqyrim të kontekstit të përgjithshëm lokal, duke pasur parasysh, se përfshihen, komuna të mëdha, të vogla, komuna kufitare, me shtrirje të madhe dhe të vogël gjeografike dhe me përfaqësim të ndryshëm të komuniteteve etnike.

Instituti KLGJ, procesin e përzgjedhjes së grupeve të Auditimit Social e ka shtrirë në tri nivele dhe dimensione: i. Përzgjedhja e koordinatorëve, aktivistë apo të angazhuar në komunitetin lokal; ii. Gjithëpërfshirja (diversiteti) brenda grupit të Auditimit Social dhe iii. Zgjerimi i grupit të Auditimit Social, sipas kontekstit dhe strukturës së projekteve të monitoruara (parqe, rrugë, terrene sportive, investime në ambient), duke siguruar edhe përfshirjen e përfituesve fundorë.



## Fokusi i Grupit të Auditimit Social në Skënderaj

Në projektin Rikonstruimi i kulmeve të shkollave në (Çirez, Llaushë dhe "Anton Qetta" - Qytet), si dhe Ndërtimi i poligonit sportiv në Shkollën "Ahmet Delia" – Qytet, në fokus kanë qenë këto aspekte: procedurat e shpalljes së tenderit, publikimi i tyre dhe përzgjedhja e operatorëve. Kurse, si pjesë e dytë e këtij fokusi ishin edhe realizimi i punimeve sipas specifikave teknike që ishin të parapara edhe në kontratën e tyre.

Indikatorët e performancës së përgatitur nga Grupi i Auditimit Social për projektet e monitoruara janë:

1. A ndoqi zbatimin një plan të qartë veprimi?
2. A ka pasur vonesa në zbatimin e projektit?
3. Nëse po, cilat ishin arsytet e vonesës?
4. Si është realizuar buxheti në relacion me planin?
5. Nëse ka pasur devijime, cilat ishin arsytimet për çdo devijim buxhetor?
6. Cilat janë rekomandimet për të përmirësuar më tej projektin?
7. A është krijuar dhe/ose përdorur ndonjë mekanizëm ankesash gjatë zbatimit?
8. A ka ndonjë ankesë të veçantë në lidhje me projektin në fjalë?

Përtej indikatorëve të vlerësimit të zbatimit, monitoruesit kanë nxjerrë të dhëna edhe për ndikimin në mjedis:

1. A ndikon projekti në degradimin e mjedisit?
2. A ndikon projekti në cilësinë e ujit?
3. A ndikon projekti në rritjen/zvogëlimin e dyoksidit të karbonit?

Indikatorët e veçantë lidhur me projektet janë:

1. Në projektin e poligonit sportiv, a është paraparë qasja e personave/fëmijëve me aftësi të kufizuara (duke qenë afër me HANDIKOS)?
2. Në procesin e planifikimit të projektit, a janë marrë parasysh, periudha e shfrytëzimit, duke qenë se hapësira është e hapur dhe a pritet një zgjidhje opsionale për mbulim?
3. Në riparimin e kulmeve të shkollave, a është kryer vlerësimi i efijencës, përfshirë (ngrohjen/apo të ftohtit) që mund të shkaktojë llamarina?
4. A planifikohet vendosja e paneleve solare apo ujëmbledhësve për shfrytëzimin e ujit nga të reshurat për mirëmbajtjen e hapësirave shkollore?
5. Përgjatë planifikimit të projektit të riparimit të kulmeve, a janë marrë në konsideratë rreziqet e rrëshqitjes (masive) të borës?
6. Në procesin e planifikimit të investimit për riparimin e kulmeve, a janë marrë në konsideratë lidhja e kulluesve (ulluqeve) me rrjetin e ujërave atmosferikë?

Kërkesat për informacion/dokumente dhe pyetjet e dërguara nga grupi i Auditimit Social në Komunën e Skënderajt:

- Kontratat me detaje janë gjetur në ueb faqen e komunës si dhe janë dërguar në e-mail.

## RRETH PROJEKTEVE

Projekti	027- Rikonstruimi i kulmeve të shkollave Çirez, Llaushë dhe “Anton Çetta” në Komunën e Skënderajt.
	Numri i prokurimit: 643-24-3856-5-2-1
Çmimi total i punëve në kontratë	160,000.00 € (ishte fondi) 120,088.80 € (punë kryesi kishte aplikuar)
Statusi i kontratës	E përfunduar

**Autoriteti Kontraktues:** Komuna e Skënderajt

**Zbatues:** N.N. “BLENDI COLOR”, NNT BINI SH.P.K. RR. 20 QERSHORI PODUJEVË

### RIKAPITULIM I PËRGJITHSHËM - SHKOLLA ÇIREZ

NR.	Kategoritë	Shuma
1	Demolimi i ulluqeve ekzistuese dhe bartja deri në deponi	840.00 €
2	Riparimi i bazës së betonit si dhe sipërfaqeve të nevojshme për ulluqe	560.00 €
3	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i ulluqeve të izoluar	4,200.00 €
4	Demolimi i pikoreve ekzistuese dhe bartja deri në deponi	200.00 €
5	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i pikoreve, si dhe sanimi	200.00 €
6	Demolimi i kulmeve ekzistuese nga llamarinat	240.00 €
7	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i kulmeve	720.00 €
8	Demolimi i gjithë hapësirës së planifikuar për rinovim	4,500.00 €
9	Furnizimi dhe montimi i sandwich panelit	47,250.00 €
10	Furnizimi me material	16,273.00 €
11	Furnizimi, transporti dhe montimi i llamarinës së plastifikuar	4,950.00 €
12	Furnizimi dhe vendosja e çdo lloji izolimi	4,200.00 €
13	Demolimi i ulluqeve vertikale	300.00 €
14	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i ulluqeve vertikale me diametër 110mm	480.00 €
15	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i ulluqeve vertikale me diametër 125mm	640.00 €
16	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i ulluqeve vertikale me diametër 160mm	540.00 €
17	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i ujëmbledhësve	204.00 €
18	Furnizimi me material dhe transporti i çdo elementi tjetër të imët	150.00 €

### RIKAPITULIM I PËRGJITHSHËM - SHKOLLA LLAUSHË

NR.	Kategoritë	Shuma
1	Largimi i strukturës së mbi-ndriçimit nga objekti	225.00 €
2	Furnizimi dhe vendosja e llamarinës përreth mbi-ndriçimit	480.00 €
3	Demolimi i strukturës së kulmit	75.00 €
4	Furnizimi dhe vendosja e llamarinës së bashku me konstruksionin përcjellës	330.00 €
5	Furnizimi me material, transporti i çdo elementi tjetër të imët	200.00 €

### RIKAPITULIM I PËRGJITHSHËM - “ANTON ÇETTA” SKËNDERAJ

NR.	Kategoritë	Shuma
-----	------------	-------

1	Demolimi i ulluqeve horizontale ekzistuese dhe bartja deri në deponi	360.00 €
2	Riparimi i bazës së betonit si dhe pjesëve tjera që është e nevojshme për ulluqe	540.00 €
3	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i ulluqeve të izoluar	2,700.00 €
4	Demolimi i pikoreve ekzistuese dhe bartja deri në deponi	200.00 €
5	Furnizimi me material, transporti, montimi i pikoreve dhe sanimi	200.00 €
6	Demolimi i kulmeve ekzistues nga llamarina	480.00 €
7	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i kulmeve	1,440.00 €
8	Demolimi i gjithë hapësirës së planifikuar për rinovim	2,016.00 €
9	Furnizimi dhe montimi i elementeve (trarëve)	9,540.00 €
10	Furnizimi, transporti dhe montimi i llamarinës së plastifikuar	11,130.00 €
11	Furnizimi dhe vendosja e çdo lloj izolimi (silikoni, buloni apo aksesori të nevojshëm)	300.00 €
12	Demolimi i ulluqeve vertikale	720.00 €
13	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i ulluqeve vertikale me diametër 110mm	720.00 €
14	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i ulluqeve vertikale me diametër 125mm	960.00 €
15	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i ujëmbledhësve	625.00 €
16	Furnizimi me material dhe transporti i çdo elementi tjetër të imët	400.00 €

Projekti	030- Poligoni sportiv në shkollën "Ahmet Delia" në Skënderaj Numri i prokurimit: 643-24-4157-5-2-1
Çmimi total i punëve në kontratë	90,858.00 €
Statusi i kontratës	E papërfunduar

**Autoriteti Kontraktues:** Komuna e Skënderajt

**Zbatues:** Grupi i Operatorëve Ekonomik, Ekrem Bislimi B.I; Adnan Bislimi B.I. Çlirimi 74.

**Vlera e Parashikuar e kontratës:** 78,000.00 euro

Projekti Poligoni sportiv në shkollën "Ahmet Delia" është ri-tenderim, vlera e parashikuar e kontratës: 78,000.00 euro, kontrata është në vlerë: 90,858.00 euro. Paraprakisht, kontrata ishte nënshkruar në vlerë: 69,850.00 euro. Por, operatori ishte tërhequr.

#### RIKAPITULIM I PËRGJITHSHËM - "AHMET DELIA" SKËNDERAJ

NR.	Kategoritë	Shuma
1	Punët e gërmimit dhe mbushjes	10,648.00 €
2	Punët e asfaltit	12,800.00 €
3	Punët metalike	35,260.00 €
4	Mobilimet	32,150.00 €

## GJETJET KRYESORE

Rikonstruimi i kulmeve dhe poligoni sportiv. Si konstatim i përgjithshëm, vlen të theksohet se: këto projekte, kanë ndikuar pozitivisht në përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës shkollore. Megjithatë, evidentohen disa mangësi nisur nga planifikimi i projekteve (shuma e parashikuar) si dhe pjesët përcjellëse të projekteve si, lidhja e kullimit të ujit (ulluqeve) me rrjetin e ujërave atmosferikë. E, po ashtu, në shkollën e Çirezit, vendosja e mbulojave pas pak vitesh kur shkolla është vendosur në funksion, reflekton nevojën për përmirësim të planifikimit bazuar në kushtet atmosferike dhe bazuar në standardet e punimeve. Ngjashëm, edhe te fusha sportive, duhet të merren parasysh disa parakushte të sigurisë dhe standardet e ndërtimit.



### Ri-konstruimi i kulmeve:

Riparimi i kulmit në shkollën “Anton Çetta”- Qytet, nuk ka paraparë masa të izolimit. Si pasojë e kësaj, mund të ndikojë në efikasitet (ftohësi dhe nxehtësi). Ndërkaq, në shkollën e Çirezit janë përdorur sandwich panel, që kanë masë izoluese dhe ndalin zhurmat (nga shiu).



Në shkollën “Anton Çetta”- Qytet, depërton drita në një hapësirë, ku nga pamja me dron vërehet se llamarina nuk është e vendosur në atë pjesë. Ngjashëm, një kullues (ulluk) vertikal, mungon në pjesën e prapme të shkollës. Si pasojë, kjo mund të çojë në rrjedhje të ujit dhe dëmtime të objektit.

### Poligoni Sportiv:



Përdorimi i materialeve të metalit në mobileri (ulëse) me konstrukcion metali si dhe mos vendosja e mbrojtëseve në gypa, paraqet rrezik të theksuar për përdoruesit.

Rrethojat anësore, nuk janë të fiksuara mjaftueshëm. Shtyllat mbajtëse dhe lidhjet me



rrethojën nuk përputhen e për pasojë, mund të paraqiten dëmtime;

### Përtej Projekteve:

Në intervenimin në shkollën “Anton Çetta”-



Qytet, projektuesi nuk ka paraparë në para-masa dhe para-llogari vendosjen e rrufepritësve. Ngjashëm edhe në shkollën e Çirezit, nga informacionet e komunës, del se kjo ka qenë e paraparë tek para-masa dhe para-llogaria furnizimi me material.



Edhe pse në para-masa dhe para-llogari nuk është specifikuar, pun kryesi ka vendosur prerësit e borës. Kjo largon rrezikun nga rrëshqitja masive e borës dhe akullit. Kjo reflektohet te punët tjera.



Në dy shkollat, Qirez dhe “Anton Çetta”- Qytet, kulluesit (ulluqet) vertikalë nuk janë të lidhur me ujëmbledhës. Për këtë, mund të shkaktohen dëmtime në objekte dhe pjesë të rrëshqitshme në trotuare. Në dy pozicione në shkollën e Çirezit, gypi lidhës dhe ai bartës nuk përputhen ( $\Phi 100$  lidhur në  $\Phi 70$ ).

### Poligoni Sportiv:

Referuar skicës së projektit, vërehet se



parametrat e terrenit dhe hapësirat përreth në pjesët anësore janë 1 metër. Ndërkaq, standardet DIN<sup>1</sup> kryesisht kërkojnë një distancë 2-3 metër. Për të shmangur rrezikun e goditjeve në rrethoja apo ulëse në këtë rast të fëmijëve.



Sigurimi i qasjes në Poligonin Sportiv për HANDIKOS-in duke qenë se objekti është afër, por mungon trotuari që mundëson përdorimin për personat me aftësi të kufizuara.

<sup>1</sup> <https://www.din.de/en/about-standards/din-standards>

## REKOMANDIME

### Rikonstruimi i Kulmeve dhe Infrastrukturës Shkollore:

#### Përmirësimi i vendosjes së llamarinës dhe elementeve të kulmit:

- Rekomandohet që llamarina në shkollën “Anton Çetta” - Qytet të rivendoset dhe të sigurohet një montim i saktë i të gjitha pjesëve të kulmit për të parandaluar depërtimin e dritës dhe rrjedhjen e ujit.

### Poligoni Sportiv

#### Përmirësimi i materialeve dhe sigurisë së mobileve:

- Rekomandohet përdorimi i materialeve sipas standardeve dhe siguria e mobileve (ulëseve) për të eliminuar çdo mundësi rreziku për përdoruesit, veçanërisht fëmijët. Duhet gjithashtu të vendosen mbrojtëse për gypat dhe pjesët metalike që mund të shkaktojnë lëndime.

#### Sigurimi i fikseve të rrethojave:

- Rekomandohet që rrethojat anësore të poligonit sportiv të kontrollohen dhe të fiksohen më mirë për të parandaluar dëmtimet dhe rrënimin e mundshëm të strukturës.

### Përtej Projekteve:

#### Përmirësimi i izolimit të kulmeve:

- Rekomandohet që ndërhyrjet në riparimet e kulmeve të marrin parasysh masat e efijencës përfshirë izolimet. Të projektohen vendosja e paneleve solare.

#### Rregullimi i sistemit të kullimit:

- Rekomandohet që të lidhen kulluesit (ulluqet) vertikalë me ujëmbledhësit në të gjitha shkollat për të parandaluar mundësinë e dëmtimeve nga rrjedhja e ujit. Si dhe të planifikohet vendosja e grumbulluesve të ujit në mënyrë që të shfrytëzohen për mirëmbajtjen e hapësirave (oborrit).

#### Përmirësimi i planifikimit të kulmeve dhe infrastrukturës:

- Rekomandohet që të bëhet një rishikim i planifikimit të projekteve duke marrë parasysh kushtet atmosferike dhe standardet e ndërtimit për të parandaluar mangësi, si ato që u evidentuan pas përfundimit të projekteve.

#### Vendosja e sistemit të rrufepritësve:

- Rekomandohet që në të gjitha shkollat të planifikohet instalimi dhe kontrolli sistematik i rrufepritësve për të parandaluar dëmtimet nga rrufeja dhe goditjet e mundshme.

#### Rritja e hapësirës për rrethojën anësore:

- Rekomandohet që hapësirat e rrethojës anësore të poligonit sportiv të zgjaten nga 1 metër në 2-3 metra, për të përmbushur standardet e sigurisë dhe për të reduktuar rrezikun e goditjeve të mundshme të përdoruesve/fëmijëve.

#### Sigurimi i qasjes për Personat me Aftësi të Kufizuara (HANDIKOS):

- Rekomandohet të sigurohet një qasje të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara në poligonin sportiv, duke ndërtuar një trotuar të qashtëm për ata që kanë nevojë për mbështetje të veçantë.

# KOMENTET E KOMUNËS

## Komentet e përgjithshme

*Në takimin me Kryetarin e Komunës dhe ekipin, u ndanë gjetjet dhe rekomandimet. Fokus i diskutimit ishin tri çështje: Projektimi i projekteve dhe standardet; siguria e përdoruesve të investimeve kapitale; si dhe qasja më gjithëpërfshirëse. Ishte konstatim i përbashkët nevoja për përmirësimin e planifikimit (projektimit) të projekteve duke marrë në konsideratë të gjitha elementet e punimeve si dhe ato afatgjate siç janë masat e efijencës. Nga procesi i Auditimit Social, përtej projekteve, është vlerësuar investimi komunal në ndërtimin e sub-qendrave në fshatrat (ish-bashkësitë lokale).*

## Komentet Specifike:

- **Rekomandimi:** Përmirësimi i izolimit të kulmeve
  - **Komenti i Komunës:** Riparimi i kulmit në Shkollën “Anton Cetta” në Qytet, nuk ka paraparë izolimin e kulmit e as vendosjen e sandwich panelit, ngase pllaka është e izoluar.
- **Rekomandimi:** Rregullimi i sistemit të kullimit
  - **Komenti i Komunës:** Në shkollën e Çirezit, pjesa akumuluese e kulmit, ka paraparë një ujëmbledhës. Ndërkaq, pjesët tjera nuk mund të lidhen ngase nuk ekziston sistemi i kullimit. Në një projekt të veçantë parashihet intervenimi në objektet dhe infrastrukturën shkollore për vendosjen e rrjetit të kullimit, apo në disa raste largimin nga objekti.
- **Rekomandimi:** Përmirësimi i vendosjes së llamarinës dhe elementeve të kulmit
  - **Komenti i Komunës:** Komuna, ende nuk ka kryer pranimin teknik të punimeve si dhe ka rekomanduar punëkryesin për përfundimin e punëve, si: riparimi i disa pjesëve në kulme si dhe vendosjen e të gjithë ujëmbledhësve (ulluqeve).
- **Rekomandimi:** Përmirësimi i materialeve dhe sigurisë së mobilierisë (ulëseve)
  - **Komenti i Komunës:** Vendosja e ulësve pa mbrojtëse (në pjesët e ndjeshme) është e përkohshme, komuna do të sigurohet që mablet (ulëset) dhe pjesa e rrethojës të garantojnë siguri, duke pasur parasysh edhe se përdoruesit janë nxënësit. Në bazë të vlerësimeve, ulëset mund të zhvendosen përtej rrethojës së poligonit sportiv.

## Përtej Projekteve:

- **Rekomandimi:** Përmirësimi i planifikimit të kulmeve dhe infrastrukturës
  - **Komenti i Komunës:** Në kuadrin e planifikimit të projekteve, rekomandohet të merren parasysh masat e efijences. Komuna, thekson se në kuadrin e kësaj, në partneritet me organizata dhe donatorë, planifikohen vendosja e paneleve solare në disa objekte. Megjithatë, e konsiderojnë të vlefshëm rekomandimin, që në proceset e ardhme të planifikimit (hartimit të projekteve) të merren parasysh edhe vlerësimi i masave të efijencës.
- **Rekomandimi:** Rritja e hapësirës për rrethojën anësore
  - **Komenti i Komunës:** Komuna merr në konsideratë rekomandimin. Edhe pse, projektuesit vlerësojnë se hapësira anësore 1m është minimalja e standardeve. Por, që vendosja e ulëseve duhet të rishqyrtohet për t’u vendosur përtej rrethojës, në një pjesë që mund të jetë investim për pjesën e trotuareve.
- **Rekomandimi:** Sigurimi i qasjes për Personat me Aftësi të Kufizuara
  - **Komenti i Komunës:** Komuna, deklaron se në bashkëpunim me shkollën dhe HANDIKOS, do të sigurohet përdorimi i poligonit nga personat me aftësi të kufizuara, përfshirë nëse ekziston nevoja për pajisje. Po ashtu, në rregullimin e infrastrukturës përcjellëse, do të ndërtohet edhe trotuari për t’u qasur në atë pjesë.

## LISTA E GRUPIT TË AUDITIMIT SOCIAL

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Organizata/Profesioni
1	Arben Veliu	Koordinator i grupit
2	Besmir Beka	Qendra Rinore
3	Rinesa Kajtazi	Qendra Rinore
4	Ken Bishop	OJQ World Hope
5	Vjollca Ramadani	OJQ "Drugëza"
6	Hana Zabeli	OJQ "Drugëza"
7	Vllaznim Bimbashi	Mësues
8	Qendrim Beka	Mësues
9	Agnesa Beka	Studente
10	Lendita Veseli	Shoqatë e grave
11	Anita Geci	Nxënëse
12	Syl Kadriu	Nxënës
13	Arsim Haziraj	HANDIKOS Skënderaj
14	Mentor Ajeti	Qendra Kosovare për Vetë përkrahje

